



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
SENATI AKADEMIK

Nr. 571 Prot.

Tiranë, 29.01 2020

VENDIM

Nr. 4 datë 29.01 2020

“Për miratimin e procedurës së përcjelljes së dosjeve të kandidatëve për fitimin e titujve akademikë “Profesor i asociuar” dhe “Profesor” Komisionit për Promovimin e Personelit Akademik”

Bazuar në nenin 38 të Ligjit nr.80/2015, datë 22.07.2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, në nenin 31 të Statutit të Universitetit të Tiranës, në Kreun IV, pika 1 të VKM nr. 112, datë 23.2.2018 “Për përcaktimin e kritereve për fitimin e gradës shkencore “Doktor” dhe të standardeve shtetërore për fitimin e titujve akademikë “Profesor i asociuar” dhe “Profesor”, i ndryshuar, si dhe në nenin 11 të Rregullores së organizimit dhe funksionimit të Komisionit për Promovimin e Personelit Akademik, Senati Akademik i Universitetit të Tiranës, në mbledhjen e tij të datës 29.01.2020,

VENDOSI:

1. Dosjet e kandidatëve për fitimin e titujve akademikë “Profesor i asociuar” dhe “Profesor”, të përcjella nga drejtuesi i njësisë kryesore, i përcillen Komisionit për Promovimin e Personelit Akademik nga Rektori.
2. Të njoftohet Senati Akademik i Universitetit të Tiranës për çdo dosje të përcjellë në Komisionin për Promovimin e Personelit Akademik.
3. Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI
PROF.DR. MYNYR KONI